



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 24.12.1-2016-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË AGJENCISË PËR
MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS**

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrë auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Igballe Halili Udhëheqëse e ekipit, Krenare Pirana dhe Vjosë Bojku anëtare, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Bujar Bajraktari.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	12
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	17
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	18
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	20
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	22

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 08/12/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Agjencisë.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Megjithatë ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpenzimet për mirëmbajtjen e komplekseve memoriale janë keqklasifikuar si investime kapitale dhe të njëjtat janë regjistruar në regjistrin e pasurive duke shkaktuar mbivlerësimin e tyre.


Për më gjerësisht shih pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Drejtorin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimit të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore janë:



Përgjigja e Drejtorit – auditimi 2016

Drejtori i Agjencisë i ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të prezantuara në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore të AMKMK-së, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se:

- Shpenzimet për mirëmbajtjen e komplekseve memoriale “Adem Jashari” dhe “Zahir Pajaziti” si dhe shpenzimet për mirëmbajtjen e ueb-faqes në vlerë totale 153,830€ janë buxhetuar dhe paguar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale. Shpenzimet e mirëmbajtjes nuk plotësojnë kriteret për tu trajtuar si “kapitale” e në veçanti pastrimi, krasitja e barit dhe mirëmbajtja e ueb faqes. Arsyeja për këtë gabim është se mjetet për këto projekte janë buxhetuar gabimisht. Kjo ka bërë që investimet kapitale të mbivlerësohen derisa shpenzimet për mallra dhe shërbime të nënvlerësohen; dhe
- Për më tutje, një pjesë e madhe e shpenzimeve për shërbimet e mirëmbajtjes të lartpërmendura ishin regjistruar në regjistrin e pasurisë duke mbivlerësuar vlerën e pasurisë për 147,995€. Kjo ka bërë që regjistri i pasurisë të mos jetë i saktë, për arsye se shërbimet e mirëmbajtjes nuk mund të trajtohen si pasuri.

Opinionin ynë nuk është modifikuar në lidhje me këto çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Drejtori i AMKMK-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Drejtori njëherit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të AMKMK-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe

vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga AMKMK kërkohet që të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK), etj.

Në kontekst të PFV-ve, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Çështjet e ngritura në Memorandumin e Auditimit, të datës 20/12/2016, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga menaxhmenti.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në MF, mund të konsiderohet që paraqet pamje të qartë dhe të vërtetë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjen e sipër përmendur ne rekomandojmë që:

Rekomandimi 1 Drejtori duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksimin e Çështjes. Fillimisht duhet bërë klasifikimin korrekt të shpenzimeve në buxhet në mënyrë që shpenzimet të mund të realizohen dhe regjistrohen në kategoritë buxhetore adekuate. Po ashtu duhet siguruar që shpenzimet e mirëmbajtjes të mos regjistrohen në regjistrin e pasurive pasi që ato nuk mund të trajtohen si pasuri.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për AMKMK-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballlet dhe të ofrojë shërbime më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet e brendshme. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda AMKMK-së veçanërisht në lidhje me mungesën e strategjisë së institucionit. Pyetësi i vet-vlerësimit, i plotësuar nga menaxhmenti e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi aranzhimet ekzistuese. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit janë të vendosura pjesërisht.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e AMKMK-së të vitit 2015 kishte rezultuar në tetë (8) rekomandime. AMKMK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen të gjitha rekomandimet. Plani i veprimit nuk ishte zbatuar plotësisht, prandaj disa nga rekomandimet përsëriten edhe këtë vit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, dy (2) rekomandime janë zbatuar, tri (3) janë në proces dhe tri (3) të tjera nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë zbatuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 2 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura	Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar sepse nuk është ndjekur ndonjë proces formal për të monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP).
Rreziku	Niveli i ulët e zbatimit të rekomandimeve ndikon që, në kontrollet e brendshme të shfaqen dobësi të vazhdueshme duke rezultuar në: <ul style="list-style-type: none">• mangësi në shpalosjen e informatave në PFV duke keq-klasifikuar shpenzimet dhe duke mbivlerësuar pasuritë; dhe• dinamikë të ngadalshme në realizimin e buxhetit për Investime Kapitale.
Rekomandimi 2	Drejtori i AMKMK-së duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në rekomandimet me prioritet të lartë.

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për AMKMK-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit.

Çështja 3 – Pyetësi i vet-vlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit nuk është hartuar; dhe
2. Pyetësi i vet-vlerësimit i plotësuar nga AMKMK-ja ka vërtetuar se ka procedura formale të dokumentuara, pasi është hartuar lista e rreziqeve dhe plani i menaxhimit të rreziqeve. Megjithatë nuk ishte bërë vlerësimi dhe monitorimi i aktiviteteve të ndërmarra.

Rreziku Mungesa e strategjisë shkakton paqartësi rreth misionit, vizionit dhe synimeve të organizatës si dhe i dobëson proceset strategjike dhe operative. Mungesa e monitorimit të aktiviteteve mund të shkaktojë mungesë të informatave në lidhje me shfaqjen e rreziqeve potenciale dhe vonesa në reagimin ndaj rreziqeve.

Rekomandimi 4 Drejtori i AMKMK-së duhet të iniciojë sa më parë hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të institucionit, e cila do t'i paraprinte proceseve tjera siç është menaxhimi i rreziqeve. Përveç kësaj monitorimi dhe raportimi mbi planin për menaxhimin e rreziqeve duhet të bëhet në baza të rregullta kohore.

2.3 Sistemi i auditimit të brendshëm

AMKMK nuk ka vendosur mekanizmin e Auditimit të Brendshëm, dhe gjatë vitit nuk është angazhuar nga jashtë një shërbim i tillë. Kjo nënkupton se menaxhmenti ka pasur mungesë të raportimit të pavarur në lidhje me funksionimin gjithëpërfshirës të kontrolleve të brendshme dhe zhvillimin e proceseve. Auditimi i Brendshëm do ta ndihmonte menaxhmentin në identifikimin dhe adresimin me kohë të sfidave dhe vështirësive eventuale përgjatë zbatimit të aktiviteteve të përditshme. Prandaj ne inkurajojmë AMKMK-në që të diskutojë me MF-në mundësinë e angazhimit të një auditori të brendshëm, apo sigurimin e shërbimeve të auditimit të brendshëm nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm në kuadër të MF-së.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e shpenzimeve. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Mënyra e klasifikimit të shpenzimeve mbetet sfidë për AMKMK-në. Kjo ndërlidhet me keq buxhetimin e këtyre fondeve, prandaj në mënyrë që të evitohet kjo duhet të përmirësohet vet procesi i buxhetimit. Kjo duhet të bëhet në bashkëpunim me MF-në. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi janë të mira, me disa përjashtime, të cilat në detaje janë shtjelluar në vazhdim të raportit.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	2,134,797	1,940,844	1,940,711	1,811,343	772,991
Granti i Qeverisë -Buxheti	2,134,797	1,940,844	1,940,711	1,811,343	772,991

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte më i ulët për 193,964€. Kjo ulje është rezultat i rishikimeve buxhetore dhe vendimeve të Qeverisë për kursime.

Në vitin 2016, AMKMK ka përdorur pothuajse 100% të buxhetit final ose 1,940,710€ të buxhetit final. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga MF.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	2,134,797	1,940,844	1,940,711	1,811,343	772,991
Pagat dhe Mëditjet	81,012	81,340	81,340	74,519	50,722
Mallrat dhe Shërbimet	44,535	34,650	34,650	40,879	24,665
Shërbimet komunale	9,250	29,250	29,169	27,953	22,005
Investimet Kapitale	2,000,000	1,795,604	1,795,552	1,667,992	675,599

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte për 327€ më i lartë në krahasim me atë fillestar. Kjo rritje ishte bërë për shkak të pa-mjaftshmërisë së mjeteve për mbulimin e pagave të muajit dhjetor;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte reduktuar për 9,885€ në krahasim me buxhetin fillestar. Kjo është bërë me vendim të Qeverisë, në kuadër të kursimeve buxhetore;
- Buxheti final për shërbime komunale ishte rritur 20,000€ në krahasim me buxhetin fillestar për arsye se fillimisht ishte aprovuar buxhet i pamjaftueshëm për këtë kategori. Shuma e lartpërmendur ishte transferuar nga kategoria e investimeve kapitale në mënyrë që të bëhej e mundur pagesa e shërbimeve komunale; dhe
- Zvogëlimi i buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale për 204,396€ ka ndodhur për shkak të pamundësisë së shfrytëzimit të tij, si pasojë e dështimit të procedurave të prokurimit.

Çështja 4 - Realizimi i buxhetit - Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Realizimi i buxhetit ishte në nivelin e pritur nëse krahasohet me buxhetin final. Megjithatë dinamika e shpenzimit nuk ishte e mirë pasi që 50% e shpenzimeve për investime kapitale është realizuar në tremujorin e fundit të vitit 2016. Kjo ka ndodhur për arsye të vonesave në procedurat e prokurimit dhe ekzekutimit të projekteve kapitale. Përveç kësaj mos realizimi i njërit nga projektet kapitale ka shkaktuar shkurtimin e buxhetit të investimeve kapitale.
- Rreziku** Mbetja e shumë pagesave për fundin e vitit mund të shkaktojë ngarkesë të zyrtarëve dhe kjo mund të rezultojë me mos aplikim efektiv të kontrolleve gjatë procesit të pagesave.
- Rekomandimi 4** Drejtori i AMKMK-së duhet të monitorojë performancën buxhetore dhe realizimin e projekteve në baza mujore si dhe të identifikojë dhe adresojë me kohë barrierat në dinamikën e realizimit të buxhetit.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar qeveritar. Kontrollat që operojnë në nivel të Ministrisë kanë të bëjnë me: autorizimin e listës së pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme, rishikimin e buxhetit, barazimet me Thesarin etj.

Çështja 5 - Ndarje jo e duhur e detyrave dhe Punë shtesë pa vendim të Drejtorit - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Në dy (2) raste nuk kishte ndarje të duhur të detyrave pasi që zyrtari i logjistikës kryente edhe detyrën e zyrtarit certifikues, dhe asistenti administrativ kryente edhe detyrat e zyrtarit zotues dhe zyrtarit të pasurisë. Nuk kishte ndonjë vendim për caktimin e punëve shtesë. Sipas menaxhmentit kjo kishte ndodhur për shkak të pamjaftueshmërisë së buxhetit për kategorinë e pagave dhe mëditjeve.
- Rreziku** Ushtrimi i dy e më shumë pozitive brenda një institucioni nga i njëjti zyrtar rrezikon procesin e funksionimit të kontrolleve të brendshme, gjithashtu kjo rezulton me konfliktin e interesit dhe zbeh rëndësinë financiare që ka përgjegjësia e deleguar.
- Rekomandimi 5** Drejtori i AMKMK-së duhet të gjejë alternativa që t'i plotësojë pozitat me zyrtarë permanent për certifikim dhe për menaxhim të pasurisë. Në të kundërt duhet të diskutojë me ndonjë institucion të pavarur për mundësinë e shfrytëzimit të përbashkët të shërbimeve për certifikimin e pagesave dhe menaxhimin e regjistrave të pasurive, ose caktimi i punëve shtesë të shoqërohet me vendime për punën shtesë.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 63,900€ (duke përfshirë edhe shërbimet komunale). Prej tyre ishin shpenzuar 63,819€. Ato kanë të bëjnë me furnizime me material harxhues, shërbime të ndryshme mirëmbajtje dhe shërbime komunale.

Çështja 6 - Mangësi gjatë pranimit të mallrave dhe shërbimeve - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Në tri (3) raste të furnizimit të mallrave në vlerë 2,641€, mungonte raporti i pranimit nga komisioni prej tre (3) anëtarëve, i cili do të konfirmonte se furnizimet ishin bërë sipas specifikacioneve të kontraktuara.
- Rreziku** Pranimi i furnizimeve në mungesë të komisionit dhe pa aplikuar kontrollet e nevojshme, rrit rrezikun që të pranohen furnizime të cilësisë jo të mirë, apo në kundërshtim me kushtet e kontraktuara.
- Rekomandimi 6** Drejtori i AMKMK-së duhet të siguroj që të gjitha mallrat dhe shërbimet të pranohen nga komisioni i caktuar i përbërë nga tre vetë. Kjo siguron që mallrat dhe shërbimet të jenë cilësore dhe në harmoni me kontratat.

3.1.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 1,795,604€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,795,522€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e monumenteve memoriale dhe realizimin e skulpturave.

Çështja 7 - Pagesa e paradhënies në kundërshtim me ligjin e buxhetit - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Ligji për Buxhetin precizon se në muajin nëntor nuk mund të ketë pagesa të paradhënies mbi 10% të vlerës së kontratës dhe atë me aprovim të Ministrit të Financave. Ne kemi vërejtur se për projektin “Ndërtimi i Bazamentit të Shtatores së William Walker në Reçak”, AMKMK, kishte paguar si paradhënie në muajin nëntor 15% të kontratës (10,442€) dhe nuk kishte marrë ndonjë aprovim nga Ministri.
- Rreziku** Pagesat e avanceve pa aprovimet e duhura është në kundërshtim me ligjin e buxhetit dhe bart me vete rrezikun që të ndodhin pagesa jashtë kontrolleve të duhura në njërin anë, dhe shmangie nga suficiti buxhetor.
- Rekomandimi 7** Drejtori i AMKMK-së duhet të sigurojë që në të ardhmen të mos ndodhin pagesa në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit dhe rregullave financiare.

Çështja 8 - Punë shtesë jashtë kontratës bazë - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Në dy³ (2) projekte ishin kontraktuar punë shtesë me vlerë totale 13,468€. Në kërkesën nga Operatori Ekonomik për punë shtesë, përfshihen rritje në sasi të disa pozicioneve sipas kontratës bazë. Kjo kishte ndodhur si pasojë të mangësive në projektet origjinale për ndërtimin e komplekseve memoriale. Punët shtesë janë arsyetuar dhe lejuar nga menaxheri i kontratës.
- Rreziku** Planifikimet jo të mira të projekteve ndikojnë që gjatë realizimit të projekteve të shfaqet nevoja për ndryshime. Kjo shkakton kosto shtesë dhe mund të ndikojë që këto shtesa të financohen nga mjetet e planifikuara për projekte tjera.
- Rekomandimi 8** Drejtori i AMKMK-së duhet të sigurojë që të gjitha projektet e planifikuara të jenë të hartuara mirë dhe të detajuara. Para hartimit të projekteve është e nevojshme që projektuesit të vizitojnë vend-ndërtimet, në mënyrë që të bëhen matjet e nevojshme konform standardeve të ndërtimit. Kjo do të shmangte fillimin e projekteve jo cilësore dhe do të evitonte kostot shtesë eventuale.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera totale neto e pasurive, e shpalosur në PFV-të e vitit 2016 ishte 4,610,165€. Prej tyre, pasuri kapitale (mbi 1,000€) ishin 4,601,872€, dhe pasuri jo kapitale (nën 1,000€) ishin 8,293€. Edhe më tej mbetet sfida për AMKMK-në aplikimi i sistemit e-pasuria, për evidentimin dhe menaxhimin e pasurive me vlerë nën 1,000€ dhe stoqeve.

Ne nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur në këtë kapitull. Çështja e mbivlerësimit të pasurisë është paraqitur më lartë në këtë raport tek Opinioni i Auditimit, si Theksim i Çështjes.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte €15,929. Këto detyrime janë bartur për tu paguar në vitin 2017, dhe janë paraqitur saktë në PFV 2016.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë

³ Ndërtimi i bazamentit të shtatores së William Walker”, dhe “Rindërtimi i memorialit të Dëshmorëve të UCK-së në Kacandoll

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Drejtori duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.3 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare	Drejtori i AMKMK-së duhet të sigurojë fillimisht klasifikimin korrekt të shpenzimeve në buxhet në mënyrë që shpenzimet të mund të realizohen dhe të regjistrohen në kategoritë buxhetore adekuate. Kjo mundëson paraqitje me të qartë lidhur me natyrën e shpenzimeve të realizuara dhe të prezantuara në PVF.			Nuk janë marrë masa
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Drejtori i AMKMK-së duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e rekomandimeve që nuk janë implementuar dhe atyre të pa adresuara.		Në proces të zbatimit	
2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit	Drejtori i AMKMK-së duhet të iniciojë sa më parë hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të institucionit, përfshirë planin për menaxhimin e rreziqeve potenciale që do të kërcënonin arritjen e objektivave të synuara. Poashtu duhet të zbatohet një proces efikas për plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe të bëhet adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive.		Në proces të zbatimit.	
2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes	Drejtori i AMKMK-së duhet të sigurojë vendosjen e një procesi adekuat për menaxhimin e rrezikut. Ky proces duhet të përfshijë hartimin e një liste të rreziqeve potenciale së bashku me masat e nevojshme për menaxhimin e tyre, si dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.		Në proces të zbatimit- lista e rreziqeve ishte përgatitur por nuk ishte monitoruar.	
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Drejtori i AMKMK-së duhet të monitorojë performancën buxhetore dhe realizimin e projekteve në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë me kohë barrierat në dinamikën e realizimit të buxhetit.			Nuk janë marrë masa.

3.4 Prokurimi	Drejtori i AMKMK-së duhet të sigurojë që të gjitha projektet e planifikuara të jenë të hartuara mirë dhe të detajuara. Para hartimit të projekteve është e nevojshme që projektuesit të vizitojnë lokacionet ku do të ndërtohen ato, dhe të bëhen matjet e nevojshme konform standardeve të ndërtimit. Kjo do të shmangte fillimin e projekteve jo cilësore dhe do të evitonte kostot shtesë eventuale.			Nuk janë marrë masa.
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Drejtori i AMKMK-së duhet të sigurojë që në rastet kur shfaqet nevoja për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm, angazhimi i tyre të bëhet përmes procedurave transparente për angazhimin sic parashihet me rregullat në fuqi.	Po		
3.6 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Drejtori i AMKMK-së duhet të sigurojë që pozitat të plotësohen me staf të rregullt dhe kontrata të rregullta të punës.	Po		

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Agjencia Për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
 Agencija sa Upravljanje Memorialnih Kompleksa Kosova
 Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo

DATË/A:	13.06.2017
REFERENC-Ë:	66.06.12
PËR/ZA/TO:	Bujar Bajraktari – AP- ZKA
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Idriz Blakaj / Drejtor - AMKMK 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Letër Konfirmim

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se: